



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.967/17 prot.

Datë 30.05.2024

### V E N D I M

Nr. 594/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.05.2024 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-96229-02-23-2024, me objekt: “Shërbim i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) mujore”, me fond limit 7,201,750.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 18.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK me NIPT L61814009B dhe adresë: Pasuria nr.1070, Zona Kadastrale 3965, Metalurgji, Bradashesh, Elbasan.

**Autoriteti Kontraktor:**

Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat me adresë: Lagjja “Kushtrim” Berat.

**Subjekte të Interesuara:** “V.A.L.E Recycling” SHPK me NIPT L28029301Q dhe adresë:  
Gurëz Fushe Kuqe Lezhe Fushe Kuqe, GUREZ, Fshatin  
Gurez, afer ish-Kanalit te Acidi

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30, të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 26.02.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-96229-02-23-2024, me objekt: “Shërbim i trajtimit dhe asgjесimit të mbetjeve spitalore për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) mujore”, me fond limit 7,201,750.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 15.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat.

II.2. Në datën 18.03.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se në datën 18.04.2024, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

-“V.A.L.E RECYCLING”	5,401,500 lekë	kualifikuar
-“ECO RICIKLIM” SHPK	6,187,500 lekë	kualifikuar
-“MEDI - TEL” SHPK	6,412,500 lekë	kualifikuar

II.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më datë 15.04.2015 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak.

II.5. Në datën 22.04.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3994 dhe me nr. 967 prot., datë 22.04.2024, e operatorit ekonomik “Eco Riciklim” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK konkretisht duke pretenduar: “*OE VA.L.E Recycling sh.p.k., nuk plotëson Kriterin 2.1.2 që përcakton se: “Per metodën dhe teknologjinë e trajtimit ME INCENERIM, Operatori Ekonomik duhet të disponoje: 2.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës: si dhe ???.* Na rezulton se në rregjistrin e ankesave te KPP më datë 20.03.2024, eshte publikuar dokumenti “Formular për publikim lidhur me arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar” me Nr. 671/2 prot, Datë 20.03.2024 per proceduren me Nr. REF-86181-11-02-2023 (i bashkelidhet kesaj Ankesë si Aneks 1).

*Ne kete formular parashtrohet se ky OE eshte skualifikuar ne proceduren me Nr. REF-86181-11-02-2023, per arsye si vijon:*

*Referuar shkresës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, administruar pranë me nr. 230/5 prot., datë 12.02.2024, ku thuhet shprehimisht se:*

*4... trupa inspektuese pranë kësaj drejtorie konstatoi se subjekti në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit ka në funksion l (një) pajisje incenerimi, ndryshe nga çfarë është e miratuar në lejen mjedisore që disponon.*

*Për këtë arsye, ndaj subjektit “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. për lejen mjedisore të tipit A me PN-8024-01-2019 me aktivitet “Incenerim 1 mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi” në bazë të ligjit nr 10448 “Për lejet e mjedisit”, 1 ndryshuar, datë 07.04.2011, neni 29, pika 1, gërma c si dhe Neni 16, pika 3 është marrë masë:*

*Dënim administrativ kryesor:*

*Gjobe 1000000 Lekë (...): Neni 29, pika 3 propozojmë: pezullimin e lejes mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, deri në realizimin e detyrave të lëna për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen.”*

*Referuar këtij komunikimi, duke u bazuar në ligjin nr. 10448/2011 dhe ligjin nr. 10431/2011, si dhe referuar nenit 82(2) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, OE, për këtë objekt prokurimi nuk krijon bindjen për zbatimin me sukses të kontratës në të ardhmen, duke qenë se ka një procedurë administrative, e cila mund të pasojë në pezullimin apo shfuqizimin e lejes së mjedisit, me të cilën paraqitet në këtë procedurë.*

*Nga sa me sipër, rezulton nga shkresa e sipercituar e AKM, se OE V.A.L.E Recycling, aktualisht në lidhje me lejen mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, e cila është Leja Mjedisore që 1 korrespondon kriterit 2.1.2 në procedure object ankimi, është minimalisht në procedure pezullimi, ose mund edhe të jete pezulluar apo shfuqizuar tashme nga Ministri i Mjedisit. Ju sjellim në vëmendje, se problemet me pajisjet dhe lejet e këtij OF janë evidentuar edhe në media në Shkurt 2024. Me shume informacion per kete gjendte ne linqet ne vijim*

*<https://www.youtube.com/watch?v=XGnDovT2rAA>*

*<https://www.youtube.com/watch?v=ZuZvyYjXFoQ>*

*<https://www.youtube.com/watch?v=pd5if9O1CyY>*

*<https://www.youtube.com/watch?v=yFUUTjTIR5M>*

*<https://www.youtube.com/watch?v=N5uzT-4O3Sw>*

*<https://www.youtube.com/watch?v=ZuZvyYjXFoQ&t=54s>*

*Ne rrethanat e mesiperme, vleresojme se duke qene se aktualisht Leja Mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, është në një procedure administrative rivleresimi, në lidhje me shkeljen e kushteve të saj nga ana e OE V.A.L.E Recycling, pra ose nuk ka garanci që ky OE do ta disponojë këtë Leje të vlefshme gjatë zbatimit të kontratës, ose kjo leje edhe mund të jete pezulluar apo shfuqizuar tashme, duhet që ky kriteri 2.1.2 të konsiderohet i papërmbushur nga ky OE.*

*2. OE V.A.L.E Recycling sh.p.k., nuk plotëson Kriterin 2.1.3 që përcakton se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt Miratimin Higjenero-Sanitar respektiv për objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve spitalore, të leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shendetesor Shtetëror)”.*

*Nga informacioni që kemi për OE V.A.L.E Recycling, për shkak të konkurimit në shumë procedura prokurimi prej shumë vitesh, na rezulton se ky OE disponon një Akt Miratimi Higjenero-Sanitar të vitit 2017, që është leshuar për instalime të trajtimit të mbetjeve spitalore, por që specifikon se mbulon instalimet “autoklave, mulli, magazine”.*

*Pra, Akt Miratimi Higjiene Sanitar ne fjale, nuk mbulon edhe instalimin e inceneratorit, cka do te thote, se objekti per pjesen qe ushtron aktivitetin e incenrimit, nuk eshte i pajisur me Akt Miratimi Higjiene Sanitar.*

*Ne rrethanat e mesiperme, kriteri 2.1.3 duhet te konsiderohet i paplotesuar.*

*3. OE VA.L.E Recycling sh.p.k., nuk ploteson Kriterin 2.3.5 qe percakton se: "Impiantet per trajtiminfasgjesisimin dhe njekohesisht makinerite per larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve te riperdorshem duhet te jene te pajisur me:*

*a) a.1. Leje Mjedisore te tipit A (III.1.C) per impiantet per asgjesimin me incenerim*

*a.2. Leje Mjedisore te tipit A (III.1.C) ose te tipit B (III.1.B) per impiantet per trajtimin pervec incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente) ose te jene pasqyruar ne akt miratimet e leshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit te paraqitura ne permbushje te kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 me sipër:*

*b) N Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerie, ku te pasqyrojë kapacitetin minimal të kërkuar në përputhje me kërkesën e mësipërme. c) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie.*

*Nga informacioni qe kemi per OE V.A.L.E Recycling, per shkak te konkurimit ne shume procedura prokurimi prej shume vitesh, per te cilat gjithashtu ka pasur nje mori ankesash, permbajtja e te cilave perfshire edhe informacionin per vleresimet, publikohet nga KPP, na rezulton se ky OE nuk e ploteson kriterin 2.3.5 per arsyet e meposhtme:*

*(i) Sic, shpjeguar me siper, Leja Mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, ku eshte i perfshire inceneratori VVFS 50, eshte ne procedure pezullimi, ose tashme e pezulluar apo e shfuqzuar, pra nuk plotesohet pika a.2 e kriterit te sipercituar*

*(ii) Ky OE nuk ka nje katalog, skede teknike, apo dokument teknik te vlefshem qe te jete origjinuar nga prodhuesi, por paraqet nje dokument pas asnje ekstremitet apo te dhena identifikuese, ku jane te pasqyruara ne menyre narrative dhe skematike te dhena per inceneratorin. Duhet sqaruar se qe nje dokument teknik te jete i vlefshem, ai duhet te jete ne nje forme te caktuar, ku dallohen qarte, te dhenat e prodhuesit, logo dhe shenja te ngjashme dalluese, adresat etj., cka edhe garanton se ky dokumentacion teknik eshte gjeneruar nga vete prodhuesi. Perndryshe, kushdo mund te prodhoje nje dokument me te dhena teknike, por nuk jep asnje garanci se keto i pergjigjen realitetit, pasi kete e garanton vetem autoresia evidente e prodhuesit. Pra nuk plotesohet pika (b) e kriterit te sipercituar*

*(iii) Duke iu refruar informacionit nga QKB, rezulton se sipas Lejes Mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, QE V.A.L.E Recycling deklaroi inceneratorin model WFS — 50, prodhim kinez i kompanise Shandong Better Environmental Protection Technology Co., Ltd. Kur ne kemi bere kerkime tregu per incenerator, kemi shqyrtuar edhe ketë product dhe një nga arsyet për të cilat nuk e kemi marrë ka qenë fakti se ky product nuk disponon Deklaratë Konformiteti CE të prodhuesit. Ne linkun e informacionit për prodhuesin ku renditen të gjitha kualifikimet e kësaj kompanie <https://www.sdbetter.net/Certificate.html>, prodhuesi nuk e deklaroi këtë produkt me Deklaratë Konformiteti CE. Tregtarë të ndryshëm të këtij produkti kur japin oferta qarkullojnë edhe një dokument të lëshuar nga një kompani certifikimi turke Udem për certifikimin e atestimit*

me Direktivën e Makinerive 2006/42/CE, por ky dokument nuk është një Deklaratë Konformiteti pasi keto janë dy gjera të ndryshme, dhe sic edhe shprehet në këtë dokument “Marka CE mund të përdoret nën përgjegjësinë e prodhuesit vetëm pas plotësimit prej tij të Deklaratës së Konformitetit CE me Direktivat përkatëse.” Gjithashtu, kjo Certificate ateston vetëm për Machinery Directive 2006/42/EC, ndërkohë që lista e Direktivave dhe Standarteve CE për të cilat duhet lëshuar Deklarata e Konformitetit CE janë:

- BS EN 746-2:1997

- Low Voltage Directive 73/23/EEC

- EMC Compatibility Regulation 89/336/EEC

- Machinery Directive 2006/42/EC (including amendment)

- (EC) No 1005/2009 on substances that deplete the ozone layer

Në kushtet e mësipërme, rezulton qartë se inceneratori model WFS — 50 i deklaruar nga OE V.A.L.E Recycling, nuk është i pajisur me Deklaratë Konformiteti CE. Pra nuk plotësohet pika (c) e kriterit të sipercituar.

4. OE V.A.L.E Recycling sh.p.k., nuk plotëson Kriterin 2.3.8 që përcakton se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimifrajtimi, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin: Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimifrajtimi brenda afatit të vlefshmerisë. Nga monitorimi i tregut dhe i konkurrencës, na rezultoi se OE V.A.L.E recycling, për përmbushjen e këtij kriteri, disponon kontratë të lidhur me shoqërinë ECO - ELB Sh.a., e cila për pranimin e produktit final që del nga proceset e trajtimit të mbetjeve spitalore me teknologjinë pa djegie dhe atë me djegie, disponon Lejen Mjedisore me PN-5783-09-2017, me Nr. Identifikimi 2694,1 datë 30.06.2022 (Anex 2 i bashkëlidhet ankesës). Në këtë Leje Mjedisore, përcaktohet se objekti i kësaj Leje, kufizohet në “Impjanti i trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit dhe prodhimit të energjisë” Pra, sipas lejes në fjalë, ky landfill/impjant mund të pranojë për depozitim vetëm mbetje të gjeneruara brenda qarkut të Elbasanit. Pra, produktet perfundimtare të gjeneruara si mbetje/teprica për landfillim, në një qark tjetër, nuk janë të autorizuar nga leja në fjalë që të depozitohen pranë subjektit ECO — ELB. Duke qenë se qendra e ushtrimit të veprimtarisë së OE V.A.L.E Recycling ndodhet në qarkun e Lezhës, edhe tepricat e gjeneruara nga proceset e trajtimit të mbetjeve nga ky OE, konsiderohen që janë gjeneruar në qarkun e Lezhës, pra nuk mund të depozitohen pranë ECO-ELB. Pavarësisht nga ekzistenca e ndonjë kontrate mes këtyre subjekteve për këtë qëllim, kjo kontratë nuk ka asnjë vlerë, për sa kohë nuk është në përputhje me kushtet e Lejes Mjedisore të subjektit prites.

Pra, në rrethanat e mësipërme, edhe kriteri 2.3.8, duhet të konsiderohet i papërbushur nga OE V.A.L.E Recycling.

*Duke u nisur nga sa parashtruar në pikat 1, 2, 3 dhe 4 më sipër, kërkojmë skualifikimin e OE V.A.L.E Recycling, për mospërbushje të kritereve 2.1.2, 2.1.3, 2.3.5 dhe 2.3.8”*

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 967/2 prot., datë 23.04.2024 .

II.7. Me shkresën e datës 23.04.2024 me lëndë “Kërkesë për vënie në dispozicion të ankesës” operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, si subjekt ndaj të cilit është bërë ankesa, iu drejtua KPP-së përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail), me kërkesën për vënien në dispozicion në rrugë elektronike të një kopjeje të ankesës së sipërcituar me argumentin se; “[...]Vënia në dispozicion e ankesës së plotë do të na mundësonte të paraqesim argumentet tona sa më të qarta dhe të bazuara në ankesën e paraqitur si dhe të paraqesim argumentet dhe shpjegimet konkrete mbi pretendimet e ankuesit, ndërsa mosvënia në dispozicion e saj do të bënte që të paraqesim argumente mbi hamendësime duke na privuar në këtë mënyrë nga pjesëmarrja aktive në proces ku jemi palë legjitime dhe e legjitimuar për të qënë pjesë.”

II.8. Me shkresën nr. 1898/1 prot., datë 25.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 967/4 prot., datë 26.04.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar në sistemin elektornik të ankesave, informacion mbi aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Eco Riciklim” SHPK, duke vendosur mospranimin e saj dhe duke argumentuar:

*Pretendimi nr.1:*

*Në lidhje me Kriterin 2.1.2 i cili percakton se: Per metoden dhe teknologjine e trajtimit me INCENERIM, OE duhet te disponoje : 2.a Leje Mjedisore te tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës:*

*- Pretendohet se Operatori Ekonomik V.A.L.E. Recycling sh.p.k nuk e ploteson kete kriter pasi, ne rregjistrimin e ankesave te KPP eshte publikuar dokumenti date 20.03.2024 “Formular per publikim lidhur me arsyet e skualifikimit ne rastin e ankesave per vendimin e vlersimi skualifikim perfundimtar” Nr.671/2prot me REF-86181-11-02-2023, nga T cili pretendohet se: -Referuar shkreses AKM, me Nr. 2305 prot date 12.02.2024, nga icili inspektoret konstatojne se V.A.L.E. Recycling ne vendndodhje ka ne funksion nje pajisje incenerimi, ndryshe nga Leja Mjedisore qe ka, si pasoje ka marre maase gjobe si dhe propozuar pezullimi I Lejes Mjedisore Tipi A, deri ne realizim te detyrave te lena.*

*Gjithashtu pretendohet se ky operatori, V.A.L.E. Recycling, si rrjelloje e sapersmendur mesiper nuk krijon bindje per zbatim te suksesshem kontrate ne te ardhme, sipas ankimit te operatorit ECO RICIKLIM.*

*Pas verifikimit të DST, të QKB (rishikohet LEJE Mjedisi Tipi A i V.A.L.E RECYCLING si dhe Akt miratimi I Lejes) dhe , kontrollit të fundit në APP (për OE të përjashtuar në Procedurat Konkurruese Koncesionare) kjo e fundit publikuar më 08.04.2024, si dhe bazuar në kërkesat e specifikimet e mirepërcaktuara në lidhje me Kriterin 2.1.2:*

*Ju bëjmë me dije se për metodën dhe teknologjinë e trajtimit ME INCENERIM, Operatori Ekonomik V.A.L.E. Recycling disponon të gjithë dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:*

*- 2.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës, leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) me afat vlefshmerie pa afat me numer PN-8024-01-2019 së bashku me Akt Miratimin përkatës, pra leje mjedisore të tipit A me nr.3781Prot. me datë 22.04.2022 me nr.identifikimi të lejes 2929/2.*

*2.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si më poshtë: 18 01 02- Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03) licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) (Grumbullim, transport, ruajtje dhe asgjësim i mbetjeve spitalore (nga kujdesi shëndetësor njerëzor dhe shtazor) me afat vlefshmerie pa afat me numer LN-6809-03-2019 së bashku me Akt Miratimin përkatës, pra Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B me nr.4233 Prot. me datë 18.06.2020 me nr.identifikimi 307/1, kodi 18 01 02 është i përfshirë në akt miratimin pika 4/c.*

*Licenca është e vlefshme për sa kohë funksionon aktiviteti i licensuar.*

*Për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.*

*Pretendimi nr.2:*

*Në lidhje me kriterin N r. 2.1.3. që përcakton se "Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt Miratimin Higjenero —Sanitar respektiv për objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve spitalore, të leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shëndetësor Shtetëror): - Pretendohet se Operatori Ekonomik V.A.L.E. Recycling sh.p.k nuk e plotëson këtë kriter pasi: Akt Miratimi Higjenero Sanitar në fjalë nuk mbulon dhe instalimin e inceneratorit, çka e bën të pavlefshme këtë AMHS.*

*Pas verifikimit në DST dhe dokumenteve të paraqitura nga OE V.A.L.E. Recycline, ju bëjmë me dije se OE ka paraqitur Akt Miratimin Higjenero —Sanitar respektiv për objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve spitalore (Për venien në shfrytëzim të objektit( destinacionit) Impiant trajtimi mbetje spitalore), të leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shëndetësor Shtetëror) me nr.07 datë 10.10.2017 me nr.serie 0000037.*

*Për sa më sipër, pretendimi juaj nuk qëndron.*

*Pretendimi nr.3: Në l*



*idhje me Kriterin Nr. 2.3.5 Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qeralpërdorim, impiante, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt ne DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe te VKM-se per miratimin e rregullores “Per menaxhimin e mbetjeve Spitalore , (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:*

*- Impiante për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente).*

*- Impiante për asgjësimin me incenerim. .*

*Makineri për larjen e kontenierëve (vetem në rastin kur do të përdoren kontenierë të ripërdorshëm) pretendohet se “nga informacioni qe keni”, per OE V.A.L.E Recyçling, nuk e ploteson kete kriter pasi: a. Leja Mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, ku eshte perfshire inceneratori WFS 50, eshte ne procedur pezullimi, b.OE nuk ka katalog, skede teknike, te vlefshem origjnuar nga prodhuesi, si dhe prodhuesi nuk e deklaroi kete product me Deklarate Konformiteti CE*

*Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE V.A.L.E. Recycling Sh.p.k rezultoi që ky OE ka paraqitur gjithë dokumentacionin e kërkuar si më sipër, madje ju bejme me dije se ne vijueshmeri per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri OE disponon dokumentat si:*

*- Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes:  
- Impiantet për trajtiminasgjësimin dhe njëkohësisht makineritë për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve te ri sërdorshem të pajisur me:*

*a) a.1, Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për impiantet për asgjësimin me incenerim a.2. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) ose të tipit B (III.1.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalentejose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër:*

*b) Katalog Iskede teknike e secilit impiant dhe makinerie, ku të pasqyrohet kapaciteti minimal i kërkuar në përputhje me kërkesën e mësipërme.*

*c) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie.*

*Ndaj pretendimi juaj në lidhje me këtë pikë nuk qëndron.*

*Pretendimi nr.4:*

*Në lidhje me Kriterin Nr. 2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt te lejuar nga AKM per depozitimin e produktit final qe del nga asgjësimiftrajtimi, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin ec hapjes se ofertave. Subjekti në fjalë duhet të*

*jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi I trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:*

*Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjesimifrajtimi brenda afatit të vlefshmerise.*

*Nga QE Ankimues ECO KRiciklim pretendohet se nga nje monitorim tregu QE V.A.LE Recyciing ka kontrat lidhur me ECO-RLB sh.a, e cila ne lejen e saj te mjedisit me PN5783-09-2017 objekti saj percakton se Impianti i trajtimit te mbetjeve urbane te Qarkut Elbasan dhe prodhimit te energjise, duke kushtezuar se mbetjet per landfillin ne nje qark tjeter nuk jane te autorizuar nga leja ne fjale.*

*Duke qen se QE V.A.L.E Recycling ndodhet ne Qarkun e Lezhes nuk i depoziton dot keto teprica t gjeneruar prane ECO-RLB sh.a. Si rezultat ECO Riciklim ne ankimim cileson se per sa kohe nuk ka perputhshmeri me kushtet e LM (lejes mjedisore) te subjektit prites duhet te konsiderohet kriter i papermbushur nga ky OE.*

*Ju bejme me dije se OE V.A.L.E. Recycling Sh.p.k rezulton që ka paraqitur gjithë dokumentacionin e kërkuar për plotësimin e kriterit të sipërpermendur, madje ju bejme me dije se në vijueshmeri për të vërtetuar përmbushjen e tij OE disponon dokumentat si:*

*Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjesimiltrajtimi brenda afatit të vlefshmerise. Paraqitur kontrata me objekt : Per depozitim mbetjesh prane impiantit te perpunimit te mbetjeve urbane qarku Elbasan me shoqerine ECO-ELB me nr.33Prot. me date 18.01.2024 me afat 1 vit, Akt miratimi Leje mjedisi tipi A, vertetim njesie me origjinalin me NR.REP 2184 i dates 30.03.2024. Ne momentin qe dokumentacioni i kerkuar eshte konform specifikimeve dhe kriterëve të DST, cdo detaj i then pa baza eshte i pa vleresueshem nga komisioni, paragjykimet e pabazuara ne ligj apo me supozime nuk ndihmojne per nje rivlersim apo ndryshim sic supozohet nga ankesa e OE ECO Riciklim.*

*Per sa me siper, pretendimi juaj nuk qëndron.*

*Komisioni në respektim të detyrimeve që burojnë nga dispozitat e ligjit nr.16272020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar si dhe VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, Komisioni i ngarkuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor për sqarimin, argumentimin, shqyrtimin si dhe dhënien e vendimit:*

#### VENDOSI:

- 1. Të mos pranojë ankesëne praqitur nga opertori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK*
- 2. Ky vendim i komunikohet menjëherë OE “ Eco Riciklim” shpk.”*

III.9. Me vendimin e ndërmjetëm nr. 433/2024, datë 26.04.2024, KPP ka vendosur:

1. *Të mos pranojë kërkesën e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK për vënie në dispozicion të ankesës me nr. 967/2024 prot, datë 22.04.2024, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-96229-02-23-2024, me objekt: “Shërbim i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 12 (dymbëdhjete) mujore”, me fond limit 7,201,750.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar me datë 15.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.10. Me datë 26.04.2024 operator ekonomik, “V.A.L.E Recycling” SHPK protokolluar me tonën me nr. 967/8 prot., datë 29.04.2024, ka paraqitur në sistem formularin e paraqitjes së argumenteve në cilësinë e subjektit të intresuar, në kuptim të nenit 113, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

II.11. Me shkresën me nr. P 24679, datë 29.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 967/9 prot., datë 02.05.2024, “Eco Riciklim” SHPK ka paraqitur në KPP prova shtesë, duke i bashkëngjitur shkresës një “printim ekrani” të faqes zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, ku rezultoni statusi “Pezulluar” i Lejes së Mjedisit tipi A, të subjektit “V.A.L.E Recycling” SHPK.

II.12. Me shkresën me nr.967/10 prot., datë 15.05.2024, KPP ka vënë në dijeni palët, se për shkak të hetimeve të mëtejshme, është e pamundur të dilet me një vendim brenda afatit të parashikuar në ligj për shqyrtimin e ankesës.

II.13. Me shkresën me nr. 967/11 prot., datë 15.05.2024, KPP iu drejtua me kërkesën për informacion Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit si më poshtë:

*Bazuar në nenin 24 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. Në kuadër të shqyrtimit të një ankesë e cila ka si objekt shërbimin e trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore për mbulimin e nevojave spitalore dhe ku si subjekt i interesuar shfaqet operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, një nga pretendimet e paraqitura në ankesë është si më poshtë vijon:*

*1. OE VA.L.E Recycling sh.p.k., nuk plotëson Kriterin 2.1.2 që përcakton se: Per metodën dhe teknologjinë e trajtimit ME INCENERIM, Operatori Ekonomik duhet të disponoje: 2.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës; si dhe ????. Na rezulton se në rregjistrin e ankesave të KPP më datë 20.03.2024, është publikuar dokumenti Formular për publikim lidhur me arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtarë me Nr. 671/ 2 prot, Datë 20.03.2024 per proceduren me Nr.*

REF-86181-11-02-2023 (i bashkelidhet kesaj Ankese si Aneks 1). Ne kete formular parashtrohet se ky OE eshte skualifikuar ne proceduren me Nr. REF-86181-11-02-2023, per arsye si vijon: Referuar shkresës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, administruar pranë me nr. 230/5 prot., datë 12.02.2024, ku thuhet shprehimisht se: "...trupa inspektuese pranë kësaj drejtorie konstatoi se subjekti në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit ka në funksion 1 (një) pajisje incenerimi, ndryshe nga çfarë është e miratuar në lejen mjedisore që disponon.

Për këtë arsye, ndaj subjektit "V.A.L.E. Recycling" sh.p.k. për lejen mjedisore të tipit A me PN-8024-01-2019 me aktivitet "Incenerim i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi" në bazë të ligjit nr 10448 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, datë 07.04.2011, neni 29, pika 1, gërma c si dhe Neni 16, pika 3 është marrë masë;

Dënim administrativ kryesor:

Gjobe 1000000 Lekë (...); Neni 29, pika 3 propozojmë: pezullimin e lejes mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, deri në realizimin e detyrave të lëna për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen."

Referuar këtij komunikimi, duke u bazuar në ligjin nr. 10448/2011 dhe ligjin nr. 10431/2011, si dhe referuar nenit 82(2) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, OE, për këtë objekt prokurimi nuk krijon bindjen për zbatimin me sukses të kontratës në të ardhmen, duke qenë se ka një procedurë administrative, e cila mund të pasojë në pezullimin apo shfuqizimin e lejes së mjedisit, me të cilën paraqitet në këtë procedurë.

Nga sa me sipër, rezulton nga shkresa e sipercituar e AKM, se OE V.A.L.E Recycling, aktualisht ne lidhje me lejen mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, e cila eshte Leja Mjedisore qe i korrespondon kriterit 2.1.2 ne procedure objekt ankimi, eshte minimalisht ne procedure pezullimi, ose mund edhe te jete pezulluar apo shfuqizuar tashme nga Ministri i Mjedisit.

.....  
Ne rrethanat e mesiperme, vleresojme se duke qene se aktualisht Leja Mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, eshte nen nje procedure administrative rivleresimi, ne lidhje me shkeljen e kushteve te saj nga ana e OE V.A.L.E Recycling, pra ose nuk ka garanci qe ky OE do ta disponoje kete Leje te vlefshme gjate zbatimit te kontrates, ose kjo leje edhe mund te jete pezulluar apo shfuqizuar tashme, duhet qe ky kriteri 2.1.2 te konsiderohet i papermbushur nga ky OE."

Sa më sipër, Komisioni Prokurimit Publik për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, kërkon nga ana juaj si organe administrative te caktuara me ligj të posacëm për lëshimin e lejeve të mjedisit, të na informoni si më poshtë vijon :

1. Cila është arsyeja që operatori ekonomik V.A.L.E. Recycling" SHPK ka marrë masë administrative lidhur me lejen mjedisore PN-8024-01-2019 dhe cila është masa e gjobës?
2. A ka një Vendim Gjyqësor që kjo masë administrative (akt) është pezulluar?
3. Leje mjedisore e leshuar nga ana juaj me këto të dhëna: PN-8024-01-2019, me datë lëshimi 22/04/2022 dhe me Kod III.1.C (), me emërtim "Leje Mjedisore e Tipit A për: Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi. Incinerimi i mbetjeve patologjike" për

*operatorin ekonomik "V.A.L.E Recycling" SHPK, është e vlefshme apo e pezulluar nga ana juaj?*

4. *A ka qënë kjo leje mjedisore e vlefshme më datë 15.03.2024?*

*Për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik si dhe për një shqyrtim më të plotë e objektiv të ankesës, lutemi brenda dy ditëve nga marrja e kësaj shkresë dërgimin e informacionit më sipër.*

II.14. Me shkresën nr.2205 prot., datë 15.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 967/12 prot., datë 17.05.2024, autoriteti kontraktor iu drejtua KPP me kërkesën për vendimmarrje sa më të shpejtë për shkak të rëndësisë së procedurës.

II.15. Me shkresën nr.5418/1 prot., datë 20.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 967/13 prot., datë 22.05.2024, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka informuar KPP si më poshtë vijon:

*Në përgjigje të shkresës suaj nr.967/11 Prot., datë 15.05.2024, regjistruar në Ajgencinë Kombëtare të Mjedisit me nr.5418 prot., datë 17.05.2024, me lëndë 'Kërkesë për informacion' ju bëjmë me dije se:*

➤ *Masa administrative e vendosur nga inspektoriati vjen si rezultat i mosplotësimit të detyrave të lëna në inspektimin me nr. çeshtje AKM-DQ-2023-000521, date 23.11.2023. Për këtë arsye, subjekti është riinspektuar në datë 25.01.2024 dhe me Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr.AKM-DQ-2023-000535-5, datë 07.02.2024 për shkak të konstatimit të shkeljeve të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 10448 datë 7.14.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, Neni 29, pika 1, germa c dhe Neni 16, pika 3, është vendosur:*

• *Dënim administrativ kryesor Gjobë: 1 000 000 Lekë.*

• *Dënimi administrativ plotësues: Referuar inspektimit të kryer në datën 23.11.2023 me nr çështje AKM-DQ-2023-000521 pasi u konstatua se instalimi I inceneratoreve në terren nuk ishte sipas kushtit nr 1 të lejes mjedisore tipi A që disponon me PN-8024-01-2019. Subjektit ju la detyrë si më poshtë: "Subjektit i lihet detyrë të marrë masat e menjëhershme për përcaktimin e saktë të instalimeve në vendodhjen e ushtrimit të aktivitetit sipas lejes mjedisore që disponon me qëllim përshtatjen e lejes mjedisore me instalimet përkatëse në vendodhjen e ushtrimit të aktivitetit." Gjatë riinspektimit në terren rezulton se subjekti nuk ka marrë masat e duhura për realizimin e detyrave të lëna. Për subjektin V.A.L.E Recycling me leje mjedisore tipi A, PN-8024-01-2019, propozojmë: Pezullimin e lejes mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, deri në realizimin e detyrave të lëna për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit.*

Pas ushtrimit të ankimit administrativ nga subjekti, vendimi i inspektimit është lënë në fuqi nga Komisioni i Ankimeve në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, me Vendimin nr. 3025 prot., datë 13.3.2024. Me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit ka nxjerrë Urdhrin nr. 141 datë 04.04.2024, nr.199715 prot., date 04.04.2024 “Për pezullimin e lejes mjedisore për subjektin “V.A.L.E. RECYCLING” shpk me PN-8024-01-2019, me veprimtari “Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. Incinerimi i mbetjeve patologjike” me vendndodhje: fshati Gurëz, afër ish-kanalit të acidit, Gurëz, Fushë Kuqe, Laç, Lezhë” deri në realizimin e detyrave të lëna nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit.

- Me Vendimin nr. Regj. Them 7505 datë 29.03.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur refuzimi i kërkesës së palës paditëse për marrjen e masës së sigurimit të padisë, në çështjen e ngritur nga pala paditëse Shoqëria V.A.L.E. Recycling shpk me objekt “Shfuqizimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024 të nxjerrë nga AKM Tiranë” kundër AKM Tiranë si palë e paditur. Çështja është në proces gjyqësor për çështjen e themelit (Shfuqizimin e aktit administrativ nr.3025 prot., datë 13.3.2024).

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është vënë në dijeni nga QKB-ja nëpërmjet shkresës me nr. 3275/33 prot., datë 25.04.2024, regjistruar në AKM me NR. 4890 prot., datë 30.04.2024 për vendimin 80-2024-1075) datë 17.04.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me palë:

Kërkues: Shoqëria V.A.L.E Recycling shpk

Palë e tretë: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Objekti: Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr. 1997/5 prot., datë 04.04.2024 Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit e cila ka vendosur:

-pranimin e kërkesës për marrje mase sigurimi padie

-pezullimin e zbatimit të aktit adminsitrativ urdhër nr. 141, datë 04.04.2024 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes administrative.

- Leja mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019 me datë 22.04.2022 me nr. identifikimi të lejes 2929/2 Vendim i Komisionit Nr.45 në emër të subjektit “V.A.L.E. RECYCLING” është leje mjedisore e vlefshme.
- Me Urdhrin nr.141 datë 04.04.2024, me nr.1997/5 prot., datë 04.04.2024 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, është urdhëruar pezullimi i kësaj leje mjedisore deri në realizimin e detyrave të lëna nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit.

*Me Vendimin nr.80-2024-1075 datë 17.04.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është pezulluar zbatimi i këtij urdhri deri në zgjidhje përfundimtare të çështjes administrative.*

*Gjithashtu bëjme me dije se, referuar kërkesave të bëra nga subjekti për plotësimin e detyrave të lëna nga grupi i inspektimit, në kuadër të ligjit nr. Nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 10 448, date 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kryer verifikimin në terren në ambjentet e ushtrimit të aktivitetit të Subjektit “V.A.L.E. RECYCLING” shpk, për lejen e mjedisit të tipit A me PN-8024-01-2019 dhe bazuar në Procesverbalin e inspektimit me Nr.AKM-DQ-2024-000122-2 datë 25.04.2024 dhe listë verifikimin Nr.AKM-DQ-2024-000122-211 datë 25.04.2024, nga grupi i inspektimit nuk janë konstatuar shkelje ligjore duke përmbushur detyrat e lëna.*

*Me shkresën nr.166 prot., datë 12.04.2024, regjistruar në AKM me nr.4139 prot., datë 12.4.2024, subjekti “V.A.L.E. Recycling” shpk, konfirmon pagesën vullnetare të gjobës prej 1 000 000 lekë, sipas vërtetimit të pagesës nga Banka Kombëtare Tregtare.”*

II.16. Me shkresën nr. 6177/2 prot., date 20.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 967/14 prot., daatë 22.05.2024, Qendra Kombëtare e Biznesit informon KPP si më poshtë:

*Në përgjigje të shkresave tuaja, me nr. 1035/10 Prot., datë 15.05 2004, protokolluar me QKB me nr. 6177 datë 17.05.2024 dhe nr.967/11 prot., datë 15.05.2024, protokolluar nga QKB me nr. 6177/1 datë 17.05.2024 ju informojmë si më poshtë:*

*Së pari, ju bëjmë me dije se, nga verifikimi i kryer në Regjistrin Kombëtar të Lejeve/Licencave dhe Autorizimeve, rezulton se, për subjektin “V.A.LE. RECYCLING” SHPK, është publikuar Urdhri i Ministrit nr.141, datë 04.04.2024 “Për pezullimin e lejes mjedisore për subjektin “V.A.LE. RECYCLING” SHPK, me PN-8024-01-2019, me veprimtari “Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. Incenerimi i mbetjeve patologjike”.*

*Referuar, nenit 12, të ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatimi i mosplotësimit të kriterëve apo shkeljes së detyrimeve bëhet, si rregull, nga organet kompetente të inspektimit ex poste.*

*Bazuar në nenin 27, të Ligjit Nr. 10 448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Ministri për lejet e mjedisit të tipave A dhe B, mund të pezullojë ose të shfuqizojë lejen e mjedisit kur:..... b) mbajtësi i lejes nuk përmbush kushtet e parashikuara në lejen e mjedisit.*

*Gjithashtu, sqarojmë se referuar, pikes 11, të nenit 14, të ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009, “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar: “Çdo institucion më kompetenca të caktuara për trajtimin e një kërkesë ose me kompetenca inspektuese, pezulluese, revokuese apo që zgjidh një ankim administrativ ndaj vendimeve të marra në ushtrimin e këtyre kompetencave, ka akses të drejtpërdrejtë në regjistër, për të publikuar kërkesat, ankimet dhe*

vendimet përkatëse dhe është i detyruar për të publikuar, përkatësisht, ankimin dhe vendimin e tij, përveçse kur parashikohet ndryshe në Këtë ligji.” Pra, nxjerrja dhe publikimi i Urdhërave të revokimit në faqen e Qendrës Kombëtare të Biznesit, është kompetencë e institucioneve inspektuese, pezulluese, revokuese dhe jo QKB-së.

Së dyti, pranë institucionit tonë, me datë 22.04.2024, është depozituar nga ana e subjektit “V.A.LE. RECYCLING” SHPK, me shkresën me Nr.1135Prot., datë 20.04.2024, “Vërtetim”, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Nr.extra Prot., datë 18.04.2024, me objekt: “Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar zbatimin e aktit administrative 199775, datë 04.04.2024, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”. Kjo çështje është gjykuar dhe është vendosur:

“1. Pranimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë.

2. Pezullimin e zbatimit të aktit administrative, Urdhër nr.141, datë 04.04.2024, të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes administrative”.

Referuar, nenit 14, pika 11, të ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, QKB, ka përcjellë për kompetencë, këtë dokumentacion, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me shkresën me nr. 327513Prot., datë 25.04.2024, si institucion me kompetenca inspektuese, pezulluese, revokuese.

Së treti, ju bëjmë me dije se, nga verifikimi i kryer në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, rezulton se, subjekti “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK, është pajisur, me Leje Mjedisit të tipit A, me numër PN-8024-01-2019, në datë 31.01.2019. Me datë 22.04.2022 është miratuar shtimi i veprimtarisë së aktivitetit, me “Aktin e Miratimit” të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Nr.3781Prot., datë 22.04.2022.

Së katërti, lidhur me pyetjen tuaj nëse leja mjedisore ka qenë e vlefshme me datë 15.03.2024, Sqarojmë se, në Regjistrin Kombëtar të Lejeve/Licencave dhe Autorizimeve, për subjektin “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK, rezulton i publikuar Urdhri i Ministrit nr.141, datë 04.04.2024 “Për pezullimin e lejes mjedisore për subjektin “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK, me PN-8024.. 01-2019, me veprimtari “Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi, Incenerimi i mbetjeve patologjike”.

Për informacion më të detajuar lidhur me revokimin e Lejes së Mjedisit të tipit A, me numër PN, 2024-01-2019, për subjektin “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK, lutemi ti drejtoheni institucioneve me kompetenca inspektuese, pezulluese, revokuese referuar ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. [...]”



### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Eco Riciklim” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK me arsyen se nuk plotëson kriterin: *”2.1.2 Per metodën dhe teknologjinë e trajtimit ME INCENERIM, Operatori Ekonomik duhet të disponoje: 2.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe 2.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte: - 18 01 02- Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Përshatshmëria për të kryer veprimtari profesionale (nëse është e aplikueshme)”, pika 2.1.2 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*2.1.2 Per metodën dhe teknologjinë e trajtimit ME INCENERIM, Operatori Ekonomik duhet të disponoje:*

*2.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe*

*2.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte:*

*- **18 01 02**- Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03);*

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër, operatorit ekonomik ankimues ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

*- Leje mjedisi PN-8024-01-2019 e tipit A me kod III.1.C dhe me emërtim përshkrues të veprimtarisë: Leje Mjedisore e Tipit A për :Incinerim i mbetjeve të rreikshme në një instaim incenerimi. Incenerim i mbetjeve patologjike.*

*-Akt Miratim Leje Mjedisore Tip A me nr. 3781 prot., datë 22.04.2022 me nr. Identifikimi të lejes 2929/2 miratuar nga ministri i Turizmit dhe Mjedisit.*

*-Licencë LN-5608-07-2018 me Kod III.2.B me emertim pershrkues të veprimtarise: Grumbullimi, transporti, ruajtja dhe asgjesimi i mbetjeve spitalore.*

*-Akt-Miratim Licence e kategorise III.2.B me Nr. Identifikimi 274/1 me nr. 4684 prot., datë 07.07.2021 miratuar nga ministri i Turizmit dhe Mjedisit.*

*-Licence LN-6809-03-2019 me Kod III.2.B me emertim pershkrues të veprimtarsë: Grumbullim, transport, ruajtje dhe asgjesim i mbetjeve spitalore (nga kujdesi shëndetësor njerëzor dhe shtazor)*

*-Akt-Miratim Licence e kategorise III.2.B me Nr. 4233 prot., datë 18.06.2020 miratuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit.*

III.1.3. Në nenin 76, pikat 3/a të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

*a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;”*

III.1.4. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.5. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

*“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që: “2.1.2 *Per metodën dhe teknologjinë e trajtimit ME INCENERIM, Operatori Ekonomik duhet të disponojë:*

*2.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe*

*2.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte:*

*- **18 01 02**- Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03);”* Për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.1.2 të këtij vendimi. Nisur nga pretendimet e ankimuesit si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumenteve të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim shqyrtimin e drejtë dhe objektiv të çështjes me shkresën me nr. 967/1 prot., datë 15.05.2024, iu drejtua Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (në vijim AKM) dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (në vijim QKB) me kërkesën për informacion si më poshtë:

*1.Cila është arsyeja që operatori ekonomik V.A.L.E. Recycling” SHPK ka marrë masë administrative lidhur me lejen mjedisore PN-8024-01-2019 dhe cila është masa e gjobës?*

*2.A ka një Vendim Gjyqësor që kjo masë administrative (akt) është pezulluar?*

*3. Leje mjedisore e leshuar nga ana juaj me këto të dhëna: PN-8024-01-2019, me datë lëshimi 22/04/2022 dhe me Kod III.1.C (), me emërtim “Leje Mjedisore e Tipit A për:Incinerimi i mbetjeve*

*të rrezikshme në një instalim incinerimi. Incinerimi i mbetjeve patologjike” për operatorin ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, është e vlefshme apo e pezulluar nga ana juaj?*

*4.A ka qënë kjo leje mjedisore e vlefshme më datë 15.03.2024?” dhe nga ku Agjencia Kombëtare e Mjedisit me shkresën nr. 5418/1 prot., datë 20.05.2024 protokolluar me tonën me nr. 967/13 prot., datë 22.05.2024, në përgjigje të kërkesës më sipër të KPP ka informuar këtë të fundit se: “Në përgjigje të shkresës suaj nr.967/11 Prot., datë 15.05.2024, regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me nr.5418 prot., datë 17.05.2024, me lëndë ‘Kërkesë për informacion’ ju bëjmë me dije se:*

*Masa administrative e vendosur nga inspektoriati vjen si rezultat i mosplotësimit të detyrave të lëna në inspektimin me nr. çështje AKM-DQ-2023-000521, date 23.11.2023. Për këtë arsye, subjekti është riinspektuar në datë 25.01.2024 dhe me Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr.AKM-DQ-2023-000535-5, datë 07.02.2024 për shkak të konstatimit të shkeljeve të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 10448 datë 7.14.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Neni 29, pika 1, germa c dhe Neni 16, pika 3, është vendosur:*

- *Dënim administrativ kryesor Gjobë: 1 000 000 Lekë,*
- *Dënimi administrativ plotësues: Referuar inspektimit të kryer në datën 23.11.2023 me nr çështje AKM-DQ-2023-000521 pasi u konstatua se instalimi 1 inceneratoreve në terren nuk ishte sipas kushtit nr 1 të lejes mjedisore tipi A që disponon me PN-8024-01-2019. Subjektit ju la detyrë si më poshtë: “Subjektit i lihet detyrë të marrë masat e menjëhershme për përcaktimin e saktë të instalimeve në vendodhjen e ushtrimit të aktivitetit sipas lejes mjedisore që disponon me qëllim përshtatjen e lejes mjedisore me instalimet përkatëse në vendodhjen e ushtrimit të aktivitetit.” Gjatë riinspektimit në terren rezulton se subjekti nuk ka marrë masat e duhura për realizimin e detyrave të lëna. Për subjektin V.A.L.E Recycling me leje mjedisore tipi A, PN-8024-01-2019, propozojmë: Pezullimin e lejes mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, deri në realizimin e detyrave të lëna për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit.*

*Pas ushtrimit të ankimit administrativ nga subjekti, vendimi i inspektimit është lënë në fuqi nga Komisioni i Ankimeve në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, me Vendimin nr. 3025 prot., datë 13.3.2024. Me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit ka nxjerrë Urdhrin nr. 141 datë 04.04.2024, nr.199715 prot., date 04.04.2024 “Për pezullimin e lejes mjedisore për subjektin “V.A.L.E. RECYCLING” shpk me PN-8024-01-2019, me veprimtari “Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. Incinerimi i mbetjeve patologjike” me vendndodhje: fshati Gurëz, afër ish-kanalit të acidit, Gurëz, Fushë Kuqe, Laç, Lezhë” deri në realizimin e detyrave të lëna nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit.*

*Me Vendimin nr. Regj. Them 7505 datë 29.03.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur refuzimi i kërkesës së palës paditëse për marrjen e masës së sigurimit të padisë, në çështjen e ngritur nga pala paditëse Shoqëria V.A.L.E. Recycling shpk me*

objekt “Shfuqizimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024 të nxjerrë nga AKM Tiranë” kundër AKM Tiranë si palë e paditur. Cështja është në proces gjyqësor për cështjen e themelit (Shfuqizimin e aktit administrativ nr.3025 prot., datë 13.3.2024).

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është vënë në dijeni nga QKB-ja nëpërmjet shkresës me nr. 3275/33 prot., datë 25.04.2024, regjistruar në AKM me NR. 4890 prot., datë 30.04.2024 për vendimin 80-2024-1075) datë 17.04.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me palë:

Kërkues: Shoqëria V.A.L.E Recycling shpk

Palë e tretë: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Objekti: Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr. 1997/5 prot., datë 04.04.2024 Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit e cila ka vendosur:

-pranimin e kërkesës për marrje mase sigurimi padie

-pezullimin e zbatimit të aktit adminsitrativ urdhër nr. 141, datë 04.04.2024 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes administrative.

Leja mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019 me datë 22.04.2022 me nr. identifikimi të lejes 2929/2 Vendim i Komisionit Nr.45 në emër të subjektit “V.A.L.E. RECYCLING” është leje mjedisore e vlefshme.

Me Urdhrin nr.141 datë 04.04.2024, me nr.1997/5 prot., datë 04.04.2024 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, është urdhëruar pezullimi i kësaj leje mjedisore deri në realizimin e detyrave të lëna nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit.

Me Vendimin nr.80-2024-1075 datë 17.04.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është pezulluar zbatimi i këtij urdhri deri në zgjidhje përfundimtare të çështjes administrative.

Gjithashtu bëjme me dije se, referuar kërkesave të bëra nga subjekti për plotësimin e detyrave të lëna nga grupi i inspektimit, në kuadër të ligjit nr. Nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 10 448, date 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kryer verifikimin në terren në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të Subjektit “V.A.L.E. RECYCLING” shpk, për lejen e mjedisit të tipit A me PN-8024-01-2019 dhe bazuar në Procesverbalin e inspektimit me Nr.AKM-DQ-2024-000122-2 datë 25.04.2024 dhe listë verifikimin Nr.AKM-DQ-2024-000122-211 datë 25.04.2024, nga grupi i inspektimit nuk janë konstatuar shkelje ligjore duke përmbushur detyrat e lëna.

*Me shkresën nr.166 prot., datë 12.04.2024, regjistruar në AKM me nr.4139 prot., datë 12.4.2024, subjekti “V.A.L.E. Recycling” shpk, konfirmon pagesën vullnetare të gjobës prej 1 000 000 lekë, sipas vërtetimit të pagesës nga Banka Kombëtare Tregtare.”*

Referuar kthim-përgjigjes së AKM rezulton, se më datë 07.02.2024, ndaj operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, për shkak të konstatimit të shkeljeve ligjore të subjektit të inspektimit është vendosur dënim administrativ kryesor gjobë 1 000 000 lekë, dhe si dënim plotësues i lihet detyrë të marrë masat e menjëhershme për përcaktimin e saktë të instalimeve në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit sipas lejes mjedisore që disponon, me qëllim përshtatjen e lejes mjedisore me instalimet përkatëse në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit dhe ku sipas AKM pas riinspektimit në terren këto detyra nuk janë plotësuar dhe për këtë subjekt u propozua pezullimi i lejes mjedisore tip A me PN-8024-01-2019, deri në realizimin e detyrave të lëna për përshtatjen e lejes mjedisore me vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit. Referuar informacionit më sipër të AKM vendimi i inspektimit pas ankimit administrativ të subjektit me vendimin nr. 33025 prot., datë 13.03.2024, është lënë në fuqi nga Komisioni i Ankimeve në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe me propozim të AKM, Ministri i Mjedisit ka nxjerrë Urdhrin nr.141, datë 04.04.2024 me nr.1997/5 prot., datë 04.04.2024, ku ka vendosur pezullimin e lejes mjedisore më sipër. Akoma më tej, AKM në shkresën e saj informon KPP, se me Vendimin nr. Regj. Them 7505, datë 29.03.2024, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur refuzimi i kërkesës së “ V.A.L.E Recycling” SHPK për marrjen e masës së sigurimit të padisë, në çështjen e ngritur nga ana e tij me objekt :“*Shfuqizimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024 të nxjerrë nga AKM Tiranë.*” Ndërsa po sipas informacionit të AKM, me Vendimin nr. 80-2024-1075, datë 17.04.2024, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur pranimi i kërkesës së “V.A.L.E Recycling” SHPK për marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr.1997/5, datë 04.04.2024 të Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit”, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Referuar situatës faktike dhe juridike të dokumentacionit të ngarkuar në sistem nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK për përmbushjen e kriterit më sipër, si dhe nga informacioni i dërguar nga AKM rezulton, se në momentin e hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit objekt – ankimi, pra më datë 18.03.2024, kemi pasur në fuqi për subjektin “V.A.L.E Recycling” SHPK, një masë administrative me gjobë prej 1000000 lekë dhe një propozim për pezullimin e lejes mjedisore për shkak të mosplotësimit të detyrave të lëna. Ashtu sikurse AKM njofton në shkresën e saj, konfirmimi i pagesës vullnetare të gjobës nga “V.A.L.E Recycling” SHPK i është njoftuar AKM më datë 12.04.2024, regjistruar me nr. 4139 prot. Ndodhur në këto kushte KPP vëren, se në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me datë 18.03.2024, çka nënkupton edhe datën e hapjes së ofertave për vlerësim, operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, ka pasur një masë administrative (gjobë pe 100000 lekë), e vendosur më datë 17.02.2024 nga AKM pas procesit të riinspektimit të subjektit, e cila nuk rezulton të jetë shlyer nga subjekti në datën 18.03.2024 (data e hapjes së ofertave), sepse sipas informacionit të AKM kjo e fundit është njoftuar për pagesën vullnetare të gjobës nga subjekti më datë 12.04.2024. Në nenin 76 pika 3/a të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në

*procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;”. Në këtë kuadër KPP gjykon, se operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, në momentin e hapjes së ofertave më datë 18.03.2024, ka pasur në fuqi një masë administrative gjobë, e vendosur në datën 17.02.2024, nga organi kompetent Agjencia Kombëtare e Mjedisit për shkelje të konstatuara në lidhje me kushtet e mjedisit, duke rënë ndesh edhe me parashikimet e nenit 76 pika 3/a të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, çka sjell skualifikimin e tij nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit objekt - ankimi. Nuk mund të lejohet paraqitja e asnjë dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave, pasi një gjë e tillë do të konsiderohej ndërhyrje në ofertë. Vlerësimi i dokumentacionit, i cili do të sigurohej në të ardhmen nga operatorët ekonomikë, do të cenonte në thelb konceptin e prokurimit publik, i cili i nënshtrohet afateve të përcaktuara procedurale ligjore. KPP nuk mund të vlerësojë një fakt apo dokument të ri pas datës së hapjes së ofertave siç është pagesa e gjobës në mënyrë vullnetare nga subjekti “V.A.L.E Recycling” SHPK për pagesën e të cilës AKM është njoftuar me datë 12.04.2024, në respektim të parimit të barazisë, mosdiskriminimit, referuar nenit 3, pika 1 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sic u arsyetua më sipër, duke qenë se në momentin e hapjes së ofertave me datë 18.03.2024, operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK ka pasur në fuqi një masë administrative gjobë, e vendosur në datë 17.02.2024 nga organi kompetent Agjencia Kombëtare e Mjedisit për shkelje të konstatuara në lidhje me kushtet e mjedisit, duke rënë ndesh me parashikimet e nenit 76 pika 3/a të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar dhe çfarë sjell skualifikimin e tij nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit objekt - ankimi.*

Sa më lart pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Eco Riciklim” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “V.A.L.E Reycling” SHPK me arsyen se nuk plotëson kriterin: “2.1.3.Operatori ekonomik duhet te paraqese Akt Miratimin Higjeno –Sanitar respektiv per objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve spitalore, të leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shendetesor Shteteror);” KPP vëren se,

III.2.1 Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Përshtatshmëria për të kryer veprimtari profesionale (nëse është e aplikueshme)”, pika 2.1.3 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*2.1.3.Operatori ekonomik duhet te paraqese Akt Miratimin Higjeno –Sanitar respektiv per objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve spitalore, të leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shendetesor Shteteror);*

III.2.2. Në përmbushje të këtj kriteri operatori ekonomik ”V.A.L.E Recycling” SHPK ka paraqitur në sistem;

*-Akt miratim Higjieno-Sanitar nr. 07 i datës 10.10.2017 lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor Dega Rjionale, Qarku Lezhë për Vale Recycling me aktivitet: Impiant i mbetjeve spitalore” Trajtim i mbetjeve spitalore të rrezikshme, autoklave,mulli,, magazine” për vënien në shfrytëzim të objektit (destinacioni) Impiant Trajtimi mbetjeve spitalore*

III.2.3. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.4. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “

*2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë*



*zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht: *“2.1.3.Operatori ekonomik duhet te paraqese Akt Miratimin Higjieno –Sanitar respektiv per objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve spitalore, të leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shendetesor Shteteror).”* Nisur nga pretendimet e ankimuesit si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumenteve të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me dokumentacionin e paraqitur e plotëson kriterin më sipër, pasi në akt-miratimin higjieno sanitar më sipër është përcaktuar aktiviteti i subjektit: *“Impiant i mbetjeve spitalore” Trajtim i mbetjeve spitalore të rrezikshme, autoklave, mulli, magazine*”, por në vetvete referuar përmbajtjes së tij, kemi një akt miratim higjieno-sanitar për vënien në shfrytëzim të objektit (destinacioni) Impiant trajtimi i mbetjeve spitalore, çfarë do të thotë që përputhet me objektin e procedurës së prokurimit dhe veprimtarinë që do të kryhet për përmbushjen e tij. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues që operatori ekonomik “V.A.L.E recycling” SHPK nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.1.3 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Përshatshmëria për të kryer veprimtari profesionale (nëse është e aplikueshme) nuk qëndron. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti

me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës, ku është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Sa më lart pretendimi i ankimesit nuk qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes "Eco Riciklim" SHPK, për skualifikimin e operatori ekonomik "V.A.L.E Recycling" SHPK me arsyen se nuk plotëson kriterin:" 2.3.5- *Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt ne DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se per miratimin e rregullores "Per menaxhimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë: - Impiant/e për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente). - Impiant/e për asgjësimin me incenerim. - Makineri për larjen e kontenierëve (vetem në rastin kur do të përdoren kontenierë të ripërdorshëm)– minimalisht copë 1 (nje) Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese: - Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi); - Impiantet për trajtimin/asgjësimin dhe njëkohësisht makineritë për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve te ripërdorshem duhet të jenë të pajisur me; 3 a) a.1. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për impiantet për asgjësimin me incenerim a.2. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) ose të tipit B (III.1.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente)ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër; b) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerie, ku të pasqyrojë kapacitetin minimal të kërkuar në përputhje me kërkesën e mësipërme. c) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie. \*Shënim nr. 1: KVO rezervon te drejten e verifikimit ne terren lidhur me funksionimin e proceseve te punes per pajisjet sa me siper. \*Shënim nr. 2: Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues. Shënim: Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.)"* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Përshatshmëria për të kryer veprimtari profesionale (nëse është e aplikueshme)", pika 2.3.5 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.5- *Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, impiant/e, makineritë e*

mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt ne DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe te VKM-se per miratimin e rregullores “Per menaxhimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

- Impiant/e për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente).

- Impiant/e për asgjësimin me incenerim.

- Makineri për larjen e kontenierëve (vetem në rastin kur do të përdoren kontenierë të ripërdorshëm)– minimalisht copë 1 (nje)

Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

- Impiantet për trajtimin/asgjësimin dhe njëkohësisht makineritë për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve te ripërdorshem duhet të jenë të pajisur me;

a) a.1. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për impiantet për asgjësimin me incenerim

a.2. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) ose të tipit B (III.1.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente)ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;

b) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerie, ku të pasqyrojë kapacitetin minimal të kërkuar në përputhje me kërkesën e mësipërme.

c) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie.

\*Shënim nr. 1: KVO rezervon te drejten e verifikimit ne terren lidhur me funksionimin e proceseve te punes per pajisjet sa me siper.

\*Shënim nr. 2: Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.

Shënim: Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

III.3.2. Në përmbushje të kriterit më sipër, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Leje mjedisi PN-8024-01-2019 e tipit A me kod III.1.C dhe me emërtim përshkrues të veprimtarisë: Leje Mjedisore e Tipit A për :Incenerim i mbetjeve të rreikshme në një instaim incenerimi. Incenerim i mbetjeve patologjike.

-Akt Miratim Leje Mjedisore Tip A me nr. 3781 prot., datë 22.04.2022 me nr. Identifikimi të lejes 2929/2 miratuar nga ministri i Turizmit dhe Mjedisit.

*-Licencë LN-5608-07-2018 me Kod III.2.B me emertim pershkrues të veprimtarisë: Grumbullimi, transporti, ruajtja dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore.*

*-Akt-Miratim Licence e kategorise III.2.B me Nr. Identifikimi 274/1 me nr. 4684 prot., datë 07.07.2021 miratuar nga ministri i Turizmit dhe Mjedisit.*

*-Licence LN-6809-03-2019 me Kod III.2.B me emertim pershkrues të veprimtarsë: Grumbullim, transport, ruajtje dhe asgjësim i mbetjeve spitalore (nga kujdesi shëndetësor njerëzor dhe shtazor)*

*-Akt-Miratim Licence e kategorise III.2.B me Nr. 4233 prot., datë 18.06.2020 miratuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit.*

III.3.3. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.3.4. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

*“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.3.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të

realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes, se operatori ekonomik "V.A.L.E Recycling" SHPK nuk e përmbush kriterin më sipër konkretisht pikën a) a.1. *Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për impiantet për asgjësimin me incenerim*" duke u shprehur, se Leja Mjedisore Tip A me PN-8024-01-2019, ku është i përfshirë inceneratori WFS 50, është në procedurë pezullimi ose tashmë e pezulluar ose shfuqizuar pra nuk plotësohet pika a.2 e kriterit të sipërcituar, KPP sic ka parashtruar me sipër në këtë vendim referuar korrespondencës me institucionet përkatëse dhe konkretisht me AKM, kjo e fundit me shkresën nr. 5418/1 prot., datë 20.05.2024 protokolluar me tonën me nr. 967/13 prot., datë 22.05.2024, ka informuar KPP se: *"[...]. Me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit ka nxjerrë Urdhrin nr. 141 datë 04.04.2024, nr.1997/5 prot., date 04.04.2024 "Për pezullimin e lejes mjedisore për subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" shpk me PN-8024-01-2019, me veprimtari "Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. Incinerimi i mbetjeve patologjike" me vendndodhje: fshati Gurëz, afër ish-kanalit të acidit, Gurëz, Fushë Kuqe, Laç, Lezhë" deri në realizimin e detyrave të lëna nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit."* Ashtu sikurse KPP ka arsyetuar më sipër, data e zhvillimit të procedurës çka nënkupton datën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave është data 18.03.2024, pra në këtë datë gjendja juridike dhe faktike e lejes së tipit A me PN-8024-01-2019 për subjektin "V.A.L.E. Recycling" SHPK nuk ka qenë e pezulluar, pasi urdhri i Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit për pezullimin e lejes më sipër, mban një datë të mëvonshme konkretisht datën 04.04.2024. Sa më sipër, rezulton, se operatori ekonomik "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, nuk është në kushtet e mospërmbushjes së kërkesave në kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon pezullimit të Lejes mjedisore të tipit A (me kod III.1.C), pasi në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit kjo leje nuk rezulton të jetë e pezulluar, pasi pezullimi i saj ka ndodhur në një datë të mëvonshme, konkretisht me urdhrin e Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit nr. 141, date 04.04.2024 "Per pezullimin e lejes mjedisore për subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, me PN-8024-01-2019, me veprimtari "Incinerimi i mbetjeve te rrezikshme ne nje

instalim incenerimi. Incenerimi i mbetjeve patologjike". Ndërsa për sa i takon pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes, se operatori ekonomik "V.A.L.E Recycling" SHPK nuk përmbush kriterin më sipër konkretisht duke argumentuar se: "Ky OE nuk ka një katalog skedë teknike apo dokument të vlefshëm të origjinuar nga prodhuesi por paraqet një dokument pa ekstremitet apo të dhëna identifikuese ku janë pasqyruar në mënyrë narrative dhe skematike të dhëna për inceneratorin..... pra nuk plotësohet pika (b) e kriterit të sipërcituar" si dhe "[...] Rezulton qartë se inceneratori model WFS-50 i deklaruar nga OE V.A.L.E Recycling nuk është i pajisur me deklaratë konformiteti CE. Pra nuk plotësohet pika (c) e kriterit të sipërcituar", KPP vëren, se për plotësimin e pikave a.2/b dhe a.2/c të kriterit më sipër, nga ana e këtij operatori ekonomik në sistemin e prokurimit elektronik nuk është dorëzuar asnjë dokument që vërteton plotësimin e kërkesave të mësipërme të autoritetit kontraktor. KPP gjykon, se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, në të cilën përcaktohet, se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" në të cilin parashikohet se "1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë." Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se "1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

*Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.*

*Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]"*

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Eco Riciklim” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK me arsyen se nuk plotëson kriterin: “2.3.8. *Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:* • *Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi brenda afatit të vlefshmerisë. "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme". \*Plotësimi i kriterit të mësipërm është i detyrueshëm vetëm për subjektet që janë të regjistruar dhe ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.”* KPP vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Përshatshmëria për të kryer veprimtari profesionale (nëse është e aplikueshme)”, pika 2.3.8 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*2.3.8. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:*

- *Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi brenda afatit të vlefshmerisë.*  
*"Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të*

*dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".*

*\*Plotësimi i kriterit të mësipërm është i detyrueshëm vetëm për subjektet që janë të regjistruar dhe ushtrojnë aktivitetet në Republikën e Shqipërisë. Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*

III.4.2. Në përmbushje të kriterit më sipër, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë “Për depozitim mбетjesh pranë impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane Qaku Elbasan” me nr. 33 prot., datë 18.01.2024, e lidhur mes shoqërisë “Eco-Elb” SH.A dhe “V.A.L.E Recycling” SHPK.

- Akt - Miratim Leje Mjedisi Tipi A për subjektin “Eco-Elb” SH.A me nr. 5364 prot., datë 28.06.2022, me nr. Identifikimi të lejes 2694/1, miratuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit.

III.4.3. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.4.4. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

*“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.4.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të



vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.6 Në rastin konkret, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, se operatori ekonomik "V.A.L.E Recycling" SHPK nuk ka plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.8 të kriteve të veçanta të kualifikimit "2.3.8. *Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01.....*" me arsyetimin, se leja mjedisore e shoqërisë "Eco-Elb" ShA, kufizohet në "Impianti i trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasani dhe prodhimit të energjisë" dhe ky landfill mund të pranojë për depozitim vetëm mbeje të gjeneruara brenda Qarkut të Elbasanit dhe duke qenë se qendra e ushtrimit të veprimtarisë të "V.A.LE Recycling" SHPK ndodhet në qarkun e Lezhës dhe tepricat e gjeneruara nga proceset e trajtimit të mbetjeve konsiderohen që janë gjeneruar në Qarkun e Lezhës pra nuk mund të depozitohen pranë "Eco-ELB" SHA, Komisioni e gjykon të padrejtë pretendimin e operatorit ekonomik "Eco-Riciklim" SHPK, pasi referuar ekstraktit historik të shoqërisë "Eco-Elb" ShA në pikën 12. "*Objekti i aktivitetit*" përcaktohet "*Grumbullimi, rehabilitimi dhe perpunimi i mbetjeve të ndryshme, organike, të ngurta, të gjelberta,..etj, në territorin administrativ të të gjithë bashkive të Qarkut Elbasan. Trajtimi i mbetjeve me djegie (incenerator). Prodhimi dhe shitja e energjise elektrike. Aktivitete të tjera në fushën e perpunimit të mbetjeve, që lejon ligji, për interesat e shoqërisë dhe të komunitetit....;*" çka do të thotë që shoqëria "Eco-Elb" ShA kryen proceset grumbulluese, rehabilituese dhe përpunuese për mbetjet në territorin administrativ të Qarkut Elbasan, por kjo nuk mund të pengojë subjekt të tjera të cilat të lidhin një kontratë me shoqërinë "Eco-Elb" SHA me qëllim grumbullimin, rehabilitimin dhe përpunimin e mbetjeve nga kjo shoqëri edhe pse nuk i përkasin

Qarkut të Elbasanit, për sa kohë që në kontratën e lidhur mes palëve me nr. 33 prot, datë 18.01.2024 në nenin 2 të saj, është e përcaktuar se shoqëria “V.A.LE Recycling” SHPK do të depozitohet mbetje të gjeneruara përgjatë mbarëvajtjes së punës së saj, mbetje të cilat janë të lejuara sipas legjislacionit në fuqi, si dhe kodet e mbetjeve të cilat do të depozitohen, përputhen me kodet, që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në kriterin kualifikues.

Sa më sipër, me anë të dokumentacionit të dorëzuar në S.P.E. nga operatori ekonomik “V.A.LE Recycling” SHPK vërtetohet se operatori ekonomik ankimues e përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.8 të dokumenteve të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit. Kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Pra, nga sa më sipër arsyetuar KPP gjykon, se operatori ekonomik “V.A.LE Recycling” SHPK, e përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.8, kriteret e veçanta të kualifikimit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Eco Riciklim” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-96229-02-23-2024, me objekt: “Shërbim i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) mujore”, me fond limit 7,201,750.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 15.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “V.A.LE Recycling” SHPK, duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**

